



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT
QENDRA E SHËRBIMEVE ARSIMORE

MODEL TESTI I MATURËS SHTETËRORE 2026

Lënda: Ekonomi

Udhëzime për maturantin/kandidatin

Testi përmban gjithsej **60 pikë**.

Koha për zhvillimin e pyetjeve të testit është **2 orë e 30 minuta**.

Testi ka **20 pyetje me zgjedhje (alternativa)** dhe pyetjet e tjera janë me **zhvillim dhe arsyetim**.

Pikët për secilën pyetje janë dhënë përbri saj.

Për përdorim nga komisioni i vlerësimit

Pyetja	1	2	3	4	5	6	7
Pikët							
Pyetja	8	9	10	11	12	13	14
Pikët							
Pyetja	15	16	17	18	19	20	21
Pikët							
Pyetja	22	23	24	25	26	27	28
Pikët							
Pyetja	29	30	31	32	33		
Pikët							


Totali i pikëve

KOMISIONI I VLERËSIMIT

1.....Anëtar

2.....Anëtar

1. Inuitët jetojnë pranë Oqeanit Arktik. Ata merren kryesisht me gjueti dhe peshkim, duke u përshtatur me klimën e ftohtë dhe duke ruajtur mënyrën tradicionale të jetesës.
Bazuar në përshkrimin e mësipërm, cilit sistem ekonomik i përket populli i Inuitëve? **1 pikë**
- A) Ekonomisë mikse.
B) Ekonomisë së tregut.
C) Ekonomisë tradicionale.
D) Ekonomisë së planifikuar.
2. Elira ka një shumë të kufizuar parash dhe po mendon midis dy zgjedhjeve: të blejë një palë kufje ose një biletë për në kinema me shoqërinë. Nëse ajo vendos të blejë kufjet, cila është kostoja oportune e kësaj zgjedhjeje? **1 pikë**
- A) Çmimi i kufjeve.
B) Koha e shpenzuar duke përdorur kufjet.
C) Përvoja e humbur nga mosshkuarja në kinema me shoqërinë.
D) Shuma totale e parave për kufjet dhe shkuarja në kinema së bashku.
3. Çfarë do të ndodh në tregun e kompjuterëve nëse ulet çmimi i mallrave plotësues në konsum si printerët, programet kompjuterike, etj.? **1 pikë**
- A) Oferta do të ulet.
B) Oferta do të rritet.
C) Kërkesa do të ulet.
D) Kërkesa do të rritet.
4. Një firmë që prodhon pajisje elektroshtëpiake vendos të rrisë sasinë e produkteve të prodhuara për shkak të rritjes së çmimit të këtyre produkteve në treg. Cili është koncepti ekonomik që shpjegon këtë marrëdhënie ndërmjet çmimit dhe sasisë? **1 pikë**
- A) Çmimi tavan.
B) Ligji i ofertës.
C) Ligji i kërkesës.
D) Çmimi dysheme.
5. Duke parë me vëmendje paraqitjen grafike të mëposhtme, cila prej alternativave pasqyron saktë ndryshimin në ekuilibrin e tregut? **1 pikë**



- A) Oferta është ulur, si pasojë çmimi është rritur dhe sasia është ulur.
B) Oferta është rritur, si pasojë çmimi është ulur dhe sasia është rritur.
C) Kërkesa është ulur, si pasojë çmimi është rritur dhe sasia është ulur.
D) Kërkesa është ulur, si pasojë çmimi është rritur dhe sasia është rritur.

6. Firma "Z", gjatë një muaji, rriti çmimin e laptopëve në masën 10%. Si pasojë, sasia e kërkuar u ul në masën 5%. Në këtë rast mund të themi se: **1 pikë**
- A) $E_d=2$ dhe kërkesa është elastike.
 B) $E_d=5$ dhe kërkesa është elastike.
 C) $E_d=0.5$ dhe kërkesa është elastike.
 D) $E_d=0.5$ dhe kërkesa është joelastike.
7. Andi ka kursyer 800 000 lekë dhe dëshiron t'i investojë ato në mënyrë të sigurt dhe të përfitojë më shumë. Ai po shqyrton disa mundësi investimi. Cila është alternativa më e mirë për Andin? **1 pikë**
- A) Depozita afatshkurtër në bankë me normë interesi 1%.
 B) Depozita bankare me afat 3 vjeçar me normë interesi 3%.
 C) Obligacionet qeveritare 3 vjeçare me normë interesi me bazë vjetore 6%.
 D) Fondi investimit sepse mund të ketë përfitime të mëdha, por nuk ka siguri të plotë.
8. Besa është studente. Familja e saj përbëhet nga katër persona. Të ardhurat mujore nga pagat e prindërve janë 90 000 lekë në muaj dhe 150 000 lekë në muaj. Ata zotërojnë një apartament me vlerë 15 milionë lekë dhe një dyqan me vlerë 8 milion lekë, që e japin me qira 70 000 lekë në muaj. Në bankë kanë një depozitë kursimi 12 mujore, me vlerë 1 milion lekë, nga e cila marrin interes mujor 3 500 lekë. Sa është vlera e të ardhurave nga pasuria për familjen e Besës? **1 pikë**
- A) 73 500 lekë
 B) 240 000 lekë
 C) 313 500 lekë
 D) 24 000 000 lekë
9. Erjoni ka vendosur të blejë disa aksione në një kompani ndërkombëtare. Cili prej pohimeve të mëposhtme është i saktë për aksionet? **1 pikë**
- A) Aksioni ka afat maturimi të paracaktuar.
 B) Aksioni është një kredi e individit në firmë.
 C) Blerësi i aksionit ka të drejtë vote në kompani.
 D) Aksioni merr fitime në formë interesi të paracaktuar.
10. Një firmë që prodhon çanta ka vendosur të zëvendësojë makineritë e vjetra me makineri të reja. Për këtë arsye, ajo ka mbajtur një përqindje të caktuar të vlerës së makinerive që janë përdorur gjatë disa viteve. Cilën mënyrë financimi po përdor firma në këtë rast? **1 pikë**
- A) Kredinë afatgjatë.
 B) Fitimin e mbajtur.
 C) Kredinë afatshkurtër.
 D) Fondin e amortizimit.

11. Ema bën këto shpenzime gjatë një muaji:

Qiraja	Fatura e energjisë dhe e ujit	Ushqime	Rroba të reja
30 000 lekë	6 400 lekë	30 000 lekë	6 000 lekë

Nga këto shpenzime që bën Ema, cilin përfshijmë në shpenzimet e pandryshueshme përgjatë një periudhe kohe? **1 pikë**

- A) Shpenzimin për qiranë.
 B) Shpenzimin për ushqim.
 C) Shpenzimin për rroba të reja.
 D) Shpenzimin për energji dhe ujë.

- 12.** Gjatë vitit 2024, Bashkimi Evropian vendosi të rrisë tarifën doganore për makinat elektrike të prodhuara në Kinë deri në masën 45.3%. Bazuar në këtë fakt, cili prej formulimeve që lidhet me qëllimet e taksimit është i saktë? **1 pikë**
- A) Të ardhurat shtetërore për Bashkimin Evropian do të ulen.
 - B) Shkalla e pabarazisë midis shtresave shoqërore do të ulët.
 - C) Makinat e importit do të shtrenjtohen, si pasojë do mbrohen prodhimet vendase.
 - D) Makinat e importit do të bëhen më të lira, si pasojë do mbrohen prodhimet vendase.
- 13.** Nga alternativat e mëposhtme, cili është shembull i një shpenzimi kapital nga qeveria? **1 pikë**
- A) Shpenzimet e qeverisë për mbrojtjen sociale.
 - B) Shpenzimet për ndërtimin e një shkolle të re.
 - C) Shpenzimet për normën e interesit për shlyerjen e borxheve.
 - D) Shpenzimet për rrogat e punonjësve të administratës shtetërore.
- 14.** Në fillimet e viteve '90 SHBA kishte rritje ekonomike dhe papunësi të ulët, si pasojë vendi deklaronte punëzënie të plotë. Cilat janë dy format e papunësisë që rezultojnë në kushtet e punëzënieve të plotë? **1 pikë**
- A) Stinë dhe ciklike.
 - B) Friksionale dhe ciklike.
 - C) Strukturore dhe ciklike.
 - D) Friksionale dhe strukturore.
- 15.** Një vend po përjeton një periudhë të rritjes ekonomike. Papunësia ka rënë ndjeshëm, njerëzit kanë më shumë të ardhura dhe shpenzojnë më shumë për mallra dhe shërbime. Gjatë kësaj periudhe, çfarë ndodh zakonisht me inflacionin? **1 pikë**
- A) Inflacioni bie për shkak të rritjes së prodhimit.
 - B) Inflacioni zhduket për shkak të një ekonomie të fortë.
 - C) Inflacioni mbetet i pandryshuar sepse tregu është stabil.
 - D) Inflacioni rritet për shkak të shtimit të kërkesës për mallra dhe shërbime.
- 16.** Në vitin 2024, një shportë mallrash bazë në ekonominë e një vendi kushtonte 10 000 lekë. Në vitin 2025, e njëjta shportë mallrash kushton 10 800 lekë. Sa është norma e inflacionit për këtë periudhë? **1 pikë**
- A) 6%
 - B) 8%
 - C) 10%
 - D) 12%
- 17.** Në vitin 2023, Luksemburgu u rendit si vendi me GDP për frymë më të lartë në botë, me vlerë prej 83 320 euro, sipas Eurostat. Cili prej formulimeve më poshtë tregon qartë konceptin e GDP-së për frymë? **1 pikë**
- A) Vlera e të mirave dhe shërbimeve pjesëtuar me numrin e popullsisë.
 - B) Vlera e të mirave dhe shërbimeve llogaritur me çmimet e vitit bazë.
 - C) Vlera e të mirave dhe shërbimeve prodhuar brenda territorit të vendit.
 - D) Vlera e të mirave dhe shërbimeve prodhuar jashtë territorit të vendit nga shtetasit e tij.
- 18.** Në vitin 1962, Shtetet e Bashkuara të Amerikës vendosën një kufizim total mbi këmbimin e mallrave dhe investimeve me Kubën. Ky kufizim zgjati rreth 50 vjet. Me çfarë forme të kufizimit tregtar kemi të bëjmë në këtë rast? **1 pikë**
- A) Embargo
 - B) Tarifa doganore
 - C) Kuota doganore
 - D) Pengesë administrative

19. Cila nga situatat e mëposhtme paraqet shembullin e një dileme etike gjatë auditimit financiar të një kompanie?

1 pikë

- A) Përdorimi i teknologjisë për të përshpejtuar procesin e auditimit.
- B) Këshillimi i kompanisë për të përmirësuar proceset e menaxhimit të financave.
- C) Fshehja e fitimit real të pasurisë për të fituar më shumë, kundrejt pasqyrit të bilancit real.
- D) Përdorimi i informacionit të besueshëm dhe të verifikuar për të raportuar rezultatet e auditimit.

20. Në procesin e aplikimit për punë, Jona në dosje dorëzoi edhe një dokument ku paraqiste me shkrim aftësitë, pikat e forta dhe arsyet pse ishte e përshtatshme për këtë vend pune. Ky dokument quhet:

1 pikë

- A) letër motivimi.
- B) potenciali personal.
- C) kompetenca personale.
- D) aftësi të transferueshme.

21. Një nga shtyllat kryesore të një sistemi ekonomik të bazuar në iniciativën e lirë është prona private, ku individët dhe bizneset kanë të drejtën të zotërojnë dhe menaxhojnë pasuritë e tyre. Shpjegoni dy shtylla të tjera të sipërmarrjes së lirë.

2 pikë

- 1) _____
- 2) _____

22. Në Teatrin Kombëtar të Operës dhe Baletit në Tiranë, do të vihet në skenë shfaqja e baletit klasik "Arrëthyesi". Në tabelën e mëposhtme jepet sasia e kërkuar e biletave për çdo nivel të dhënë çmimi.

Çmimi (P)	500 lekë	1 000 lekë	2 000 lekë	3 000 lekë	3 500 lekë
Sasia e kërkuar (Qd)	1 200	1 000	800	600	400

Duke ditur se kapaciteti i sallës në Teatrin Kombëtar të Operës dhe Baletit është 800 vende, gjeni:

3 pikë

- 1) sa do të jetë çmimi ekuilibër? _____
- 2) nëse çmimi i vendosur nga teatri do të jetë 1 000 lekë, sa spektatorë mbeten pa bileta? _____
- 3) Paraqiteni situatën grafikisht. _____

23. Gjatë një takimi pune, drejtues të Bankës Botërore u shprehën se pavarësia e Bankës së Shqipërisë duhet mbrojtur dhe forcuar. Si një institucion i pavarur, cilat janë tre funksione të rëndësishme të Bankës së Shqipërisë, përveç ruajtjes së stabilitetit makroekonomik.

3 pikë

- 1) _____
- 2) _____
- 3) _____

- 24.** Firma "A" për të prodhuar produktet e saj ka kryer këto shpenzime: lënda e parë 60 000 lekë, interesi bankar 10% për kredinë e marrë në vlerën 5 000 000 lekë. Firma paguan pagë 7000 lekë për secilin punëtor dhe ka punësuar gjithsej 30 punëtorë. Firma ka prodhuar gjithsej 2 000 njësi produkti të cilat i shet me çmimin 2500 lekë/ njësi. Duke u bazuar në këto të dhëna, llogaritni: **3 pikë**

- 1) Të ardhurat e firmës. _____
- 2) Shpenzimet e përgjithshme të firmës. _____
- 3) Rezultatin financiar (fitimin ose humbjen) e firmës. _____

- 25.** Tabela e mëposhtme jep të dhëna mbi prodhimin dhe kostot e përgjithshme të një firme që vepron në periudhë afatshkurtër.

Q	0	1	2	3	4	5	6
TC	100	250	340	410	490	570	680

Duke u bazuar në të dhënat e tabelës, llogaritni:

4 pikë

- 1) koston totale mesatare (ATC) për prodhimin 5 _____
- 2) koston margjinale (MC) për prodhimin 4 _____
- 3) koston fikse mesatare (AFC) për prodhimin 6 _____
- 4) koston e ndryshueshme mesatare (AVC) për prodhimin 2 _____

- 26.** Një kompani bujqësore synon të krijojë një fermë për prodhimin e produkteve organike. Për të rritur prodhimet organike, ajo ka nevojë për më shumë tokë bujqësore. Duke ditur se oferta për tokë në periudhë afatshkurtër është plotësisht joelastike, analizoni: **3 pikë**

- 1) çfarë ndodh me kërkesën për tokë bujqësore që përdoret për prodhimin e produkteve organike?

- 2) çfarë ndodh me çmimin (rentën) e tokës bujqësore?

- 3) Paraqiteni situatën grafikiisht.

27. Qeveria vendos të rrisë shpenzimet publike për të nxitur rritjen ekonomike, duke marrë borxh, por kjo çon në rritje të deficitit buxhetor dhe borxhit publik. Duke u mbështetur në këtë situatë, formuloni një argument pro dhe dy argumente kundër deficitit buxhetor dhe borxhit publik. **3 pikë**

Pro

- 1) _____
- _____

Kundër

- 1) _____
- _____
- 2) _____
- _____

28. Tabela e mëposhtme tregon disa të dhëna statistikore të shprehura në milionë lekë të një vendi të caktuar. **3 pikë**

Shpenzimet për konsum	80	Eksportet	20
Investimet	40	Ndihma sociale	20
Shpenzimet qeveritare	70	Pagat e punonjësve	50
Importet	30	Të ardhurat nga interesat	20

- 1) Përcaktoni një komponent prej të dhënave të mësipërme që përfshihet në llogaritjen e GDP-së me metodën e të ardhurave.
- _____
- 2) Llogaritni vlerën e GDP-së me metodën e shpenzimeve në bazë të të dhënave të mësipërme.
- _____
- 3) Cila prej të dhënave të listuara **nuk** merr pjesë në asnjë prej metodave të llogaritjes së GDP-së?
- _____

29. Një kompani shet laptopë dhe ka vendosur të ulë çmimin nga 800€ në 750€. Pas kësaj, ata vërejnë se sasia e laptopëve të shitur është rritur nga 500 në 550 njësi. **4 pikë**

Duke përdorur formulën (me pikën e mesit) e elasticitetit zonal, llogaritni:

- 1) përqindjen e ndryshimit në çmim.
- _____
- 2) përqindjen e ndryshimit në sasinë e kërkuar.
- _____
- 3) sa është elasticiteti?
- _____
- 4) si është kërkesa në këtë rast?
- _____

30. Një shtet po përjeton një periudhë inflacioni të lartë pas një rritjeje të shpejtë të kërkesës dhe rritjes së çmimeve. Për të kontrolluar inflacionin, Banka Qendrore vendos të zbatojë një politikë monetare shtrënguese. Bazuar në situatën e mësipërme:

4 pikë

a) cili do të jetë ndikimi i kësaj politike në lidhje me ofertën monetare?

b) analizoni tre instrumente monetare që përdor Banka Qendrore për të ulur normën e inflacionit.

1) _____

2) _____

3) _____

31. Jona sapo është punësuar si menaxhere hoteli. Ajo duhet të realizojë operacionet e përditshme si shërbimet ndaj klientëve, menaxhimin financiar dhe strategjitë e marketingut. Shpjegoni tri aftësi të rëndësishme që do ta ndihmojnë Jonën për të patur sukses në punë dhe për të ndërtuar marrëdhënie bashkëpunimi me të tjerët.

3 pikë

1) _____

2) _____

3) _____

32. J. Mentzer u rrit në familje emigrantësh në SHBA. Nën kujdesin e xhaxhait, kimist që krijonte formula për kujdesin e lëkurës, ajo fitoi një përvojë praktike për produktet kozmetike. Në 1946, themeloi zyrtarisht kompaninë e saj me produkte kozmetike cilësore, të diferencuara nga konkurrentët. Produktet nuk janë të testuara tek kafshët dhe nuk kanë elementë kimikë të dëmshëm. Përgjatë viteve, zgjeroi aktivitetin në tregun ndërkombëtar. Shpjegoni tre elementë që e kanë ndihmuar J. Mentzer për të hapur dhe menaxhuar një sipërmarrje të suksesshme.

3 pikë

1) _____

2) _____

3) _____

33. Një firmë vepron në konkurrencë të plotë në periudhë afatshkurtër. Sasia optimale e produktit që prodhon firma për të maksimizuar fitimin është 7 400 njësi, ndërsa kosto e përgjithshme mesatare (ATC) është 30 lekë/njësi. Nëse firma shet produktin e saj me çmimi 34 lekë/njësi, llogaritni:

2 pikë

1) sa është kosto totale (TC) e firmës?

2) sa është fitimi ose humbja e firmës për këtë sasi optimale?